

20232624551

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

L I G J

I HUAMARRJES SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT ME HUA NGA BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM – BANKA BOTËRORE LIDHUR ME MARRËVESHJEN E HUAS PËR POLITIKAT ZHVILLIMORE TË QËNDRUESHMËRISË DHE REZISTENCËS

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut merr hua në Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Banka Botërore, në vlerë prej 93.800.000 eurove, të destinuar për politikën zhvillimore të qëndrueshmërisë dhe rezistencës.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas së nenit 1 të këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshjen e huas për politikën zhvillimore të qëndrueshmërisë dhe rezistencës, që do të nënshkruhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Banka Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Marrëveshjen e huas së cekur në paragrafin (1) të këtij neni, do ta nënshkruajë ministri i Financave.

Neni 3

Afati për shlyerjen e huas së nenit 1 të këtij ligji është 11 vjet, me periudhë grejs të përfshirë prej katër vitesh e gjashtë muajsh.

Norma e interesit është EURIBOR gjashtëmujor me marginë variabile.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së huas së cekur në nenin 2, paragrafi (1) të këtij ligji, Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Banka Botërore provizion të njëhershëm në vlerë prej 0.25% nga vlera e huas.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Banka Botërore provizion në vlerë prej 0.25% nga pjesa e patërhequr e huas në nivel vjetor.

Huaja e nenin 1 të këtij ligji do të shlyhet në 13 këste gjysmëvjetore, më datë 15 qershor dhe 15 dhjetor të çdo viti.

Neni 4

Shfrytëzuesi i mjeteve të huas së cekur në nenin 1 të këtij ligji është Ministria e Financave.

Neni 5

Republika e Maqedonisë së Veriut do ta shlyejë huan e nenin 1 të këtij ligji nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.